

**V E N D I M**  
**Nr.375, datë 14.7.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.437, DATË 3.9.1993, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.437, datë 3.9.1993, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime.
  - a) Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtëme bëhet:  
Drejtore i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.  
Këshilltar i plotfuqishëm, i ngarkuar për bashkërendimin ndërmjet organeve të policisë tatimore dhe doganore 56 760 lekë
  - b) në pikën 2, paga mujore për funksionin e zëvendës drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve bëhet 40 535 lekë.
  - c) Në pikën 3 niveli më i ulët i pagës bëhet 8 470 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (kryetar dege, drejtor drejtorie), bëhet 22 385 lekë në muaj.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen, në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.
3. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**